

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.11.12.2020*

11.12.2020

Ora 18:30

RENDI I DITËS

Projektakti “Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, N.Mezini**
- **Parti Politike PD, LSI, PSD**
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator, i nderuar Komisioner, të nderuar përfaqësues të partive politike parlamentare, vijojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator me pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit “Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”. Një nga aktet të cilit i kanë paraprirë të gjitha këto debate, njërin prej të cilëve sapo e përfunduar me Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Do t’i drejtohesha Komisionerit Shtetëror të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.11.12.2020*

Zgjedhjeve, zotit Ilirjan Celibashi për të na paraqitur në mënyrë të përmbledhur aktin dhe relacionin përkatës. Duhet thënë që propozohet një ndryshim në raport, të paktën me vitin 2017, për sa i përket qarqeve Gjirokastrë, Dibër dhe Tiranë. Zoti Celibashi.

Z.I.Celibashi: Faleminderit zonja Nano, ky akt sikurse dhe ju e thatë është një akt nga më të rëndësishmit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ka të bëjë direkt me një element të rëndësishëm të procesit zgjedhor sikurse është ndarja e mandateve për çdo zonë zgjedhore. Kodi Zgjedhor e ka përcaktuar shumë qartë kriterin mbi të cilin bazohet KQZ-ja në përcaktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore. Ky kriter bazohet në numrin e shtetasve për çdo qark dhe llogaria bëhet mbi numrin total të shtetasve që pjestohet me numrin 140 të mandateve që ka Kuvendi i Shqipërisë. Kjo mesatare llogaritet me numrin e shtetasve për çdo qark. Është tërësisht një veprim matematikor por që lidhet me saktësinë e pasqyrimit të të dhënave që kanë të bëjnë me numrin e shtetasve për çdo qark. Sikurse ju evidentuat, qëllimi i gjithë këtij diskutimi dhe i këtyre dëgjësave dhe shkëmbimi i informacionit me DPGJC ka të bëjë pikërisht me saktësinë e këtyre të dhënave. Nga gjithë ai debat, nqs mund ta përkufizojmë kështu atë diskutim që bëmë me Drejtorin e Përgjithshëm të Gjendjes Civile, unë mendoj që duhet ta qartësojmë opinionin publik dhe çdo person tjetër të interesuar, parti politike, apo tjetër që në lidhje me kriteret e përcaktimit dhe rregullat që janë ndjekur për ndarjen e numrit të mandateve për çdo qark, nuk ka dhe nuk rezulton të ketë asnjë lloj problemi. Problematika që mund të ekzistojë, le të pranojmë për një moment se ekziston një problematikë në lidhje me adresat e vendbanimit të qytetarëve, nuk do të ndikojë edhe nëse do të ekzistojë ky problem në çfarëdo lloj graviteti të tij. Nuk ndikon aspak në kriterin në bazë të të cilit përcaktohet numri i mandateve për çdo qark. Të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.11.12.2020*

paktën deri në momentin që ne flasim nuk kemi asnjë provë, qoftë dhe indirekte për të provuar të kundërtën. Gjithësesi shqetësimi i të gjithë ne si institucion, por dhe i partive politike në lidhje me këtë çështje ka qenë një shqetësim i përligjur dhe i shëndetshëm pasi në fund të fundit na ka sqaruar të gjithëve në lidhje me këtë situatë. Besoj se ka sqaruar edhe opinionin publik dhe këdo tjetër. Është e rëndësishme ta theksoj këtë që për sa i përket kriterit dhe procedurës së ndjekur në lidhje me përcaktimin e numrit të mandateve për çdo qark, ne nuk kemi asnjë lloj problemi sikurse nuk kemi absolutisht asnjë lloj problemi edhe për sa i përket listës së zgjedhësve në tërësi. Çështjet e tjera që kanë të bëjnë me regjistrin e adresave, janë çështje të cilat meritojnë vëmendje dhe të adresohen. Ne, qoftë dhe si qytetarë kemi të drejtën dhe interesin që të diskutojmë dhe të angazhohemi për këtë çështje, por për momentin dhe për përgjegjësinë që kemi duhet të fokusohemi tek ajo çfarë ligji na ngarkon. Në raport me atë që ligji ne na ngarkon, unë mendoj që ne jemi lehtësisht në pozitën për të miratuar aktin të cilin kemi propozuar. Pra, ndarja e mandateve dhe numri i tyre për çdo qark sikurse rezulton nga llogaritjet që ka bërë administrata e KQZ-së është në përputhje të plotë me të gjitha të dhënat që kanë ardhur nga DPGJC. Më shumë se kaq nuk mendoj se do të ishte e nevojshme për të thënë dhe për të sqaruar, ju faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Celibashi! Në vijim të asaj çfarë thatë ju, unë do të shtoja gjithashtu që ky akt vjen sot për t'u shqyrtuar dhe miratuar në Komisionin Rregullator, në respekt të afateve të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Përveç këtyre diskutimeve që sapo thamë debateve dhe seancave dëgjimore dhe komunikimeve zyrtare me DPGJC, në respekt të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja i është drejtuar zyrtarisht DPGJC e cila ka sjellë një informacion me të dhënat e caktuara në datën 27 Nëntor 2020. Referuar nenit 76, pika 2 të Kodit Zgjedhor, brenda 15

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.11.12.2020*

ditëve nga data e dërgimit të të dhënave nga DPGJC, KQZ-ja përkatësisht Komisioni Rregullator në rastin tonë, ka detyrimin të miratojë këtë akt. Afati i fundit 15-ditor është nesër, kështu që ne jemi brenda afatit të parashikuar nga Kodi Zgjedhor. Së pari, do tu drejtohem anëtarëve të Komisionit Rregullator për të diskutuar në parim rreth projektaktit. Më tej përfaqësuesve të partive politike. Të nderuar kolegë, nëse dikush nga ju ka diçka për të diskutuar në parim rreth projektaktit? Po zonja Vukaj kishit diçka ju?

Znj.H.Vukaj: Dëgjuam zotin Doracaj, jemi njohur dhe me aktet shkresore që ai ka sjellë. Besoj shumë në relatimin e zotit Celibashi, thjesht mbetemi në garancinë ligjore që do të ketë përmbajtja e këtij akti.

Znj.I.Nano: Faleminderit, nëse anëtarët e Komisionit Rregullator nuk kanë diçka për të diskutuar në parim, do të ftoja përfaqësuesit e partive politike parlamentare, nëse dikush nga ata ka diçka për të diskutuar në parim rreth projektaktit me të cilin jeni njohur.


Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Lëvizja Socialiste për Integrim nuk ka asnjë kundërshtim, e nderuar!

Znj.I.Nano: Faleminderit! Zoti Kaso a keni diçka në parim për projektaktin në emër të partisë që përfaqësoni, ju lutem?

Z.I.Kaso, përfaqësuesi i PD-së: Jo, Kryetare nuk kam asgjë!

Znj.I.Nano: Faleminderit! Zoti Preçi ju nqs keni diçka në emër të subjektit tuaj?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.11.12.2020*

Z.R.Preçi, përfaqësuesi i PSD-së: Faleminderit, nuk kemi asgjë!

Znj.I.Nano: Duke ju falenderuar, i ftoj kolegët e Komisionit Rregullator të votojmë në parim projektaktin.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet në parim projektaktin “Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

Kalojmë në diskutimin për çdo pikë.

Pika e parë për të cilën na duhet të vendosim është:

Të miratojë caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021 si më poshtë:

Qarku Berat – 7 (shtatë) mandate

Qarku Dibër – 5 (pesë) mandate

Qarku Durrës – 14 (katërbëdhjetë) mandate

Qarku Elbasan – 14 (katërbëdhjetë) mandate

Qarku Fier – 16 (gjashtëmbëdhjetë) mandate

Qarku Gjirokastrë – 4 (katër) mandate

Qarku Korçë – 11 (njëmbëdhjetë) mandate

Qarku Kukës – 3 (tre) mandate


Qarku Lezhë – 7 (shtatë) mandate

Qarku Shkodër – 11 (njëmbëdhjetë) mandate

Qarku Tiranë – 36 (tridhjetegjashtë) mandate

Qarku Vlorë – 12 (dymbëdhjetë) mandate

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.11.12.2020*

Në total janë 140 mandate sikundër Komisioneri e theksoi më sipër. Për publikun do të doja të theksoja që ndryshimet që sjell ky projektakt në raport me zgjedhjet e kaluara për Kuvendin të vitit 2017, janë këto: Qarkut Dibër i pakësohet një mandat, nga gjashtë mandate në pesë. Qarkut Gjirokastrë i pakësohet një mandat nga pesë mandate në katër dhe Qarkut Tiranë i shtohen dy mandate. Pra, dy mandatet që pakësohen nga Qarku Dibër dhe Qarkut Gjirokastrë i shtohen Qarkut Tiranë. Në diskutimin nen për nen më së pari sipas rregullores tonë i jepet fjala përfaqësuesve të partive politike nëse kanë ndonjë propozim konkret. Nëse jo, anëtarët e Rregullatorit lidhur me pikën 1 të projektvendimit? Nëse nuk kemi ndonjë propozim konkret për shtesë, apo ndryshim do të ftoja anëtarët e Komisionit Rregullatorit të votojmë pikën 1 të projektvendimit sipas projektit të sjellë nga Komisioneri.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 1!

Pika 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Pika 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.11.12.2020*

Miratohet!

Është momenti të votojmë në tërësi projektaktin “Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.

Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Komisioni Rregullator sapo miratoi një nga vendimet më të rëndësishme të tij. Vendimi “Caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”. Me këtë rast dhe për publikun do të doja të theksoja diçka. Ky është një nga dy rastet që Kodi Zgjedhor parashikon një shumicë të thjeshtë për miratimin e aktit, në bazë të nenit 20, pika 2, germa b të Kodit Zgjedhor, caktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore miratohet me shumicë të thjeshtë. Pra dhe një shumicë prej tre votash do të ishte e mjaftueshme për ta miratuar. Por personalisht si Kryetare e Komisionit Rregullator ndjehem shumë mirë që këtë akt e votuam me unanimitet duke i hapur rrugë një lloj garancie për zgjedhësit për një proces të cilin shpresoj që ta zhvillojmë dhe ta përmbyllim me sukses. Duke ju falenderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, duke mos patur asnjë çështje tjetër për diskutim, do të doja ta mbyllja mbledhjen. Faleminderit dhe një herë, takohemi në mbledhjen e radhës, mirë u pafshim!

Vendimi nr.7

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

